



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA / MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME / DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES / DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-149, Rregulloren Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

Titulli i punës: Drejtor

Institucioni: Qendra për Trashëgimi Kulturore-Gjakovë

Kategoria funksionale : Koeficienti: 9

Numri i referencës: 67 /2017

I përgjigjet: Drejtorit të Departamentit për Trashëgimi Kulturore

Vendi: Gjakovë

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Departamentit për Trashëgimi Kulturore, përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e poshtëshënuara:

1. Menaxhon punën e përgjithshme të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore Gjakovë, cakton e objektivat dhe zhvillon planin e punës, për përmbushjen e këtyre objektiveve;
2. Menaxhon stafin e QRTK Gjakovë dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të ofruar produkte dhe shërbime cilësore;
3. Bënë vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime/ përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
4. Menaxhon ofrimin e produkteve dhe shërbimeve në fushën e trashëgimisë kulturore;
5. Zhvillon dhe propozon politika në lidhje me trashëgiminë kulturore dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre;

6. Ekzaminon dhe ofron komente rreth projektligjeve dhe akteve nënligjore dhe koordinohet me Departamentin Ligjor të MKRS-së, për dizajnimin e rregulloreve rreth trashëgimisë kulturore;

7. Koordinon punën dhe bashkëpunon me drejtorët tjerë të institucioneve;

8. Bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij/saj dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre, në përputhje me standardet e kërkuara.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e Trashëgimisë Kulturore;
2. Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim;
3. Shkathtësi në caktim të objektivave , planifikim të punës dhe analizë ;
4. Shkathtësi në udhëheqje dhe organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose grup punues ;
5. Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
6. Diplomë universitare, në drejtimit: Arkitekturë, Histori, Arkeologji, Histori e Artit, Etnografi, Konservim, Restaurim dhe Menaxhim të Trashëgimisë Kulturore, Juridik, minimum 5 vite përvojë pune profesionale;
7. Vërtetim nga Gjykata që nuk është nën hetime.

Procedurat e konkurrimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët .

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të pacaktuar.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë.

Data e fundit e aplikimit është: 06.12.2017

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni mund të shkarkohet nga Web faqja e MKRS-se dhe dorëzohet në zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211 449 dhe 038 211 921 (apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>). „Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-149 mbi Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës“. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.